



BISEDË ME KRYETARIN E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS Z.LUTFI HAZIRI ME RASTIN E TRE VJETORIT TË THEMELIMIT TË AKK-SË

Progresi i arritur i Kosovës ka bazë të madhe edhe në të arriturat e pushtetit lokal

Zoti kryetar, AKK-ja në fund të qershorit feston tre vjetorin e themelimit. Çka mund të thuani në këtë trevjetor, ku ka synuar të jetë dhe ku është AKK-ja?

Progresi i arritur në Kosovë në vitet e pasluftës dhe afrimi aq afër formalizimit të zgjidhjes së statusit të Kosovës është edhe progres i të arriturave të pushtetit lokal në Kosovë e në këtë rast edhe i Asociacionit të Komunave të Kosovës si organizim në nivelin kombëtar i Kuvendeve Komunale të Kosovës. Andaj synimi ynë ka qenë mbështetja dhe promovimi i punës së pushtetit lokal dhe në imazhin që gëzon sot, tregon se ato synime përafërisht janë arritur. Në këtë përvjetor dua të falenderoj Këshillin e Kryetarëve të Komunave të Kosovës dhe anëtarët e Bordit të AKK-së për bashkëpunimin shumë të mirë.

Poashtu vërehet edhe një aktivitet i dendur i Juaji dhe vetë AKK-së në planin ndërkombëtar. Sa ka arritur që AKK të përfitoj nga vendet tjera dhe të prezentoj pushtetin lokal të Kosovës në arenën ndërkombëtare?

AKK-ja me punën e vet serioze e voluminoze dhe në pasqyrimin e qartë të të arriturave të pushtetit lokal të Kosovës në arenën ndërkombëtare ka arritur që të ketë statusin e vëzhguesit në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale në Evropë, të Këshillit të Evropës. Poashtu Asociacioni është Anëtar i Përhershëm i NALAS-it (Rrjeta e Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Jug-Lindore). Asociacioni ka kooperim shumë të ngushtë me Agjencionin e Demokracisë Lokale të Këshillit të Evropës me bazë në Gjilan si dhe ka ngritur një bashkëpunim të mirë me Asociacionet dhe Autoritetet lokale Rajonale. Ndërsa nga takimet e vizitat e ndryshme, kryetarët e komunave kanë arritur të mësojnë konkretisht mënyrën e funksionimit të pushtetit lokal në arenën ndërkombëtare e sidomos të vendeve që kanë kaluar nëpër tranzicion.



Ditë më parë keni mbajtur një takim me AKM-në për menaxhimin e pronës komunale. Cili është qëndrimi i pushtetit lokal të Kosovës për këtë çështje të rëndësishme dhe cilat janë lëvizjet e fundit në këtë drejtim?

Kthimi i menaxhimit të pronës komunale në institucionet e zgjedhura lokale nuk ka alternativë, jo pse neve na pëlqen kjo por zhvillimet ekonomike dhe sociale në Kosovë determinojnë këtë fakt. Askush tjetër përveç komunave nuk ua di hallin dhe problemet popullit të Kosovës andaj edhe plotësimi dhe ofrimi i parakushteve për zhvillim ekonomik edhe përmes realizimit të projekteve komunale duhet të bëhet nga niveli lokal si mundësi e tejkalimit të krizave të mundshme ekonomike. Ne, komnatat e Kosovës shumë seriozisht e sinjorisht jemi ulur me punuar me AKM-në në këtë drejtim pa asnjë ekuivok dhe tani jemi në realizim të formimit të grupit miks i cili do të merret shumë intensivisht me këtë çështje e e cila është në interes të të gjithëve, si qytetarëve ashtu edhe institucioneve duke përfshirë edhe AKM-në dhe suksesin e misionit ndërkombëtar në Kosovë.

Pothuajse barra kryesore në Reformimin e Pushtetit Lokal të kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare bie mbi AKK-në. Cili është mendimi Juaj dhe ku është Kosova në këtë reformim?

Reformimi i pushtetit lokal në Kosovë duhet të bëhet por me shumë kujdes dhe paralelisht me procesin e zhvillimeve politike e ekonomike në Kosovë. Andaj reformim të pushtetit lokal në Kosovë do të ketë por në asnjë mënyrë nuk do të kenë sukses tentativat që përmes reformimit të pushtetit lokal të legjitimojnë formimin edhe zyrtarë të teritoreve komunale në baza etnike. Kjo edhe në Evropë sot është e papranueshme.

Cili është mesazhi juaj për udhëheqësit komunalë dhe ku mendoni se do të jetë AKK-ja pas 3 viteve tjera?

Rruga e nisur e udhëheqjeve komunale të legjitimuara me votën e qytetarëve duhet vazhduar edhe më tej. Kjo rrugë përfshin që nga ofrimi i shërbimeve të përditshme për qytetarët, krijimin e infrastrukturës për një jetë sa më të lehtë e deri tek ngritja dhe forcimi i institucioneve komunale deri aty ku të gjithëve do t'u hiqen dyshimet për stabilitet të qëndrueshëm komunal. Pothuaj, udhëheqjet komunale kanë filluar punën nën zero dhe kështu sot duhet të jemi të kënaqur (edhe pse vend për kënaqësi ndoshta nuk guxojmë të kemi) se kemi krijuar bazat e institucionit lokal të përgjegjshëm sa para nevojave të qytetarëve ashtu edhe para zgjedhësve dhe se fushëveprimtaria e udhëheqjeve komunale fillon dhe mbaron në shërbimin ndaj qytetarëve. Pushteti lokal në Kosovë pas disa viteve do të duhet të ishte në mision të njëjtë, në këtë shërbim ndaj qytetarëve por në suaza të përmirësimeve të vazhdueshme. Pushteti lokal në vitet që vijnë do të reformohet krahas zhvillimeve politike e ekonomike me synimet tona nacionale për të cilin kemi krijuar bazamentin dhe kemi plotësuar shumicën e parakushteve.

Komunat janë të vetmet institucione që janë ulur me punuar me AKM-në për privatizimin

Organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, kryetarët e komunave të Kosovës së bashku me kryeshefat ekzekutiv kanë debatuar me përfaqësuesit më të lartë të AKM-së lidhur me menaxhimin e pronës komunale.

Derisa sesionin e hapjes e ka bërë z. Lutfi Haziri kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës, z. Adem Salihaj kryetar i Komisionit mbi Pronat Komunale në AKK njoftoi të pranishmit për letërën që këshilltari ligjor në UNMIK z. Alexander Borg Olivier i ka dërguar z. Salihaj në lidhje me menaxhimin e pronës komunale, e cila u vlerësua si shumë e paqartë edhe pse letra e tij ka krijuar mundësinë që komunat t'i rikthejnë pronat e tyre për interes të përgjithshëm, për ndërtimin e shkollave, spitaleve etj. Z. Salihaj ka theksuar se gjithë problemet në këtë rrafsh janë të lidhura me procedurat dhe mënyra e rimarrjes së tyre, sepse përveç faktit së krijohet kjo mundësi, prapë ekziston forma e refuzimit nga AKM-së nëse nuk ka kompenzim.

Zëvendës drejtori i AKM-së z. Ahmet Shala tha se "Privatizimi është një sfidë e veçantë dhe është e natyrshme që merr shumë kohë sikur edhe në shtetet tjera që kanë kaluar këtë fazë. Është e njohur se privatizim të përkryer askund në botë nuk ka pasur por do të mundohemi të kemi një privatizim të pranueshëm. Në këtë plan nëse do të kemi përkrahjen e komunave si deri më tani do ta tejkalojmë më lehtë këtë sfidë e që besojmë se edhe takimi i sotëm do të qartësojë këtë pozicion. Ndërmarrjet shoqërore janë jo vetëm pengu i mbushjes së buxhetit të Kosovës por është edhe një bagazh i pronës socialiste e me të cilin nuk mund të hyjmë në institucionet evropiane. Secila zhagjitje na shkakton ngadalësim e ky është ngadalësim prek zhvillimin e komunave e të cilat janë të parat institucione që ballafaqohen me problemet e përditshme të qytetarëve. AKM-ja menaxhon me ndërmarrjet shoqërore e publike por jo edhe me pronën komunale të cilën komunat e kanë në ngastrat e tyre".

Z. Daniel Themen - udhëheqës për bujqësi e pylltari në AKM paraqiti Rolin tradicional të Komunave, Mandantin e AKM-së, Rolin e Komunave, Përfitimin e Komunave nga Privatizimi (investimet private dhe të ndërkombëtare, të ardhurat nga tatimet, hapjen e vendeve të reja të punës, caktohen të drejtat pronësore dhe ato përcaktojnë një perspektivë të zhvillimit ekonomik), raportet AKM – Komuna si dhe paraqiti tri opsione për tranferin e tokës së ndërmarrjeve shoqërore në pronë komunale për nevojat e komunës që nga propozimi, vlerësimi dhe vendimin e përbashkët. Komunat kanë të drejtë në 'ndërrim të tokë' me Ndërmarrjet Shoqërore për të lejuar planet e Komunës për zhvillim".

Z. Sabri Zylfiu – zyrtar për patundshmëri dhe çështje kadastrale në AKM paraqiti rrugën për të regjistruar në ngastrat komunale pronën e ndërmarrjeve shoqërore.

Kryesuesi i takimit z. Adem Salihaj theksoi edhe një herë se në letërën e Borg Olivier komunat pa dilema kanë të drejtë në pronën komunale dhe se janë lënë tri mundësi të rrikthimit të pronave komunale; e para – me ndërrim të pronave nëse komuna e posedon këtë, forma e dytë – blerja e pronës nga ndërmarrjet shoqërore dhe e treat – që komuna t'i marrë me qira për kohë të caktuar.

Z. Alan Packer udhëheqës i IFES Ltd. tha se "në lidhje me të drejtën që u mohohet komunave për menaxhimin e pronës komunale, vetëm në çështjen e tokës që ipet për përdorim



ndërmarrjeve merret si totalisht korrekte pozita e Kosovës e qershorit 1999. Kjo mbledhje do të jetë e suksesshme vetëm nëse bëjmë diçka konkrete për komunat. Unë ftoj që në këtë takim të kemi mendjen e hapur për të gjetur një zgjidhje që komunat të kenë mundësi të punojnë në ndërtimin e shkollave parqeve dhe nevojave tjera të qytetarëve në pronën komunale". Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës Lutfi Haziri tha se "AKM-ja ka goditje paramortale derisa komunat janë të vetmet institucione që janë ulur me punuar me AKM-në për privatizimin dhe për të gjetur zgjidhje si me ec tutje. Qasja e komunave në këtë segment është shumë e sinqertë për t'i zgjedhur problemet e pronave komunale. Unë uroj që nga puna jonë e përbashkët t'i ndryshohet titulli i Deklaratës Parimore të AKK-së nga 'Shpronësimet e



"Uji që del i turbulltë në burim nuk mund ta pastroj atë as shtrati i lumit", dhe kjo është puna e komunave në procesin e privatizimit, edhe pse ne jemi munduar dhe do të mundohemi 'ta pastrojmë ujin' gjatë rrjedhjes mirëpo pa kthimin e pronave për menaxhim nga komunat nuk do të arrihet në zgjedhjen e shumë problemeve që kanë qytetarët" - ka thënë kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z. Lutfi Haziri.

pronës komunale' në "Ripronësimet e pronës komunale." Kuvendet Komunale duhet që në mënyrë urgjente të definojnë tokat dhe pronat komunale në territorin e tyre që janë të nevojshme për nevojat komunale si tokat për varreza, hapësira publike, rregullimin e infrastrukturës, planet strategjike urbane etj. Dobësi e AKM-së janë edhe Zyrat Regionale të cilat janë shumë burokratike. Unë dua të citoj fjalën e një zyrtari regional të AKM-së ku i është drejtuar një kryetari të komunës së "unë kam të drejtë me të detyruar me paguar edhe duke ecur edhe nëpër rrugë" dhe ky 'bashkëpunim' ka sjell fustrimin e komunave dhe qytetarëve". Kryetari i Prishtinës z. Ismet Beqiri tha se "mendimi im është që pronat shoqërore ti kthehen komunave dhe ne duhet të bisedojmë se si të bëhet kjo. Këtu hyn përveç pronës edhe ndërmarrjet komunale që janë formuar me vendim të KK-së e sot ato nuk i menaxhojmë ne. Edhe ndryshimet e destinimeve të pronës komunale mund ti japin vetëm Kuvendet Komunale kurse prona komunës duhet t'u kthehet vetëm për interes të qytetarëve prandaj nuk duhet të shtruhet dilema a do të kthehet prona komunave apo jo. Komunat nuk kanë tokë as për varreza dhe kjo është e papranueshme". Drejtori për koordinimin e pesë regjioneve të AKM-së z. Scot Bover tha se "AKM-ja menaxhon dhe administron me pronat, derisa t'i kthehen ato pronarit, sepse AKM-ja për momentin nuk e di kush janë pronarët e vërtet të pronës së Ndërmarrjeve Shoqërore nëpër komuna". Në këtë takim kanë diskutuar edhe kryetari i komunës së Lipjanit z. Xhevat Olluri, z. Ramë Manaj kryetar Klinës, z. Ismet Hashani kryetar Obiliqit z. Shaip Surdullli kryetar Kamenicës, z. Mustafë Pllana kryeshef ekzekutiv i Mitrovicës, z. Ahmet Latifi – kryeshef ekzekutiv i Skënderajit, z. Sylejman Sopa zyrtar për marrëdhënie juridike në komunën e Therandës etj. Në përmblyllje të takimit Adem Salihaj kryetari i Komisionit për Pronë në Asociacionin e Komunave të Kosovës tha se nga takimi i sotëm shihet se ka përparime edhe pse ato nuk janë kristalizuar tërësisht. Komunat nuk kanë shumë pronë komunale sa për kompenzim kur atyre u duhen vendet për realizimin e projekteve të tyre sepse ato janë pa vlerë dhe nëpër fshatra ose rrugëve që tek ne njihen si 'utrina'. Njëra ndër marrëveshjet e këtij takimi ishte që AKK-ja dhe AKM-ja të formojnë një grup miks për definimin e gjërave që dalin nga Letra e Olivier dhe përfundimisht të sqarojnë këtë çështje shumë të rëndësishme për zhvillimin lokal.

PAS TRE VITE PUNE TË ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS

U formua Bordi Këshillëdhënës i Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave të Kosovës

Anëtarë të Bordit Këshillëdhënës të Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave të Kosovës janë zgjedhur Sami Hamiti – Komuna e Prishtinës, Enver Muja – Komuna e Gjilanit, Astrit Haraçia – Komuna e Gjakovës, Naim Ismajli – Komuna e Shtimës, Mustafë Pllana – Komuna e Mitrovicës, Ragip Gajraku – Komuna e Prizrenit dhe një vend është i rezervuar për komunitetin serb.

Në një takim të Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe IFES Ltd. me Kryeshefat Ekzekutiv të Komunave të Kosovës është formuar Bordi Këshillëdhënës i Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave të Kosovës. Bordi është formuar me qëllim që të përkrahet Asociacioni duke involvuar aftësitë dhe eksperiencën e Kryeshefave Ekzekutiv dhe stafit tjetër komunal dhe duke u bazuar në paragrafin 4.21 të Statutit të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Pas hapjes së debatit nga drejtori ekzekutiv i AKK-së z.Sazan Ibrahim i lidhje me rëndësinë dhe hapat për formimin e Bordit Këshillëdhënës i Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave të Kosovës kanë diskutuar kryeshefat ekzekutiv. Sami Hamiti, kryeshef ekzekutiv në komunën e Prishtinës tha se "ne shefat ekzekutiv kemi një organ konsultativ të quajtur Kolegjiumi i Kryeshefave dhe ne mendojmë se kjo iniciativë është mjaft e qëlluar sepse ne në punën tonë ballafaqohemi përcdo ditë me ligjet dhe rregulloret e ndryshme".

Ragip Gajraku shef i ekzekutiv në Prizren tha se "është mirë që bëhet kjo dhe duhet të bëhet lobimi i punës sonë e cila ka munguar deri më tani".

Naim Ismajli shef i ekzekutiv në komunën e Shtimës tha se "edhe deri më tani ne kemi punuar në programet dhe projektet e AKK-së por jo në këtë formë dhe tani bëhet në formë zyrtare.

Mustafë Pllana shef i ekzekutiv në Mitrovicë shtoi se "ky Bord i Kryeshefave Ekzekutiv mund të ndihmoj shumë Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe ne duhet të kemi edhe zyrën tonë në lokalet e AKK-së në mënyrë që shërbimet tona të bashkëpunojnë mes vete". Në këtë takim kanë diskutuar edhe z.Enver Muja kryeshef ekzekutiv në komunën e Gjilanit, Halil Musliu kryeshef ekzekutiv i Vitisë, Ibrahim Kryeziu kryeshef i ekzekutiv në Rahovec etj.

Alan Packer udhëheqës i IFES Ltd tha "interesi im është që të shoh promovimin e zhvillimit të komunave prandaj me këtë rast na duhet edhe punë edhe politikë por edhe punë profesionale siç duhet të jetë aktiviteti i Bordit të Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave të Kosovës. Asociacioni i Komunave të Kosovës ka një përvojë të madhe dhe organizimin e takimeve vjetore së bashku me kryetarët e komunave dhe kryeshefave ekzekutiv do të ishte punë e shkëlqyeshme në gjetjen e balanceve mes këtyre niveleve për veprim të përditshëm".

Objektivat e këtij organi këshillëdhënës, sipas drejtorit ekzekutiv të AKK-së, Sazan Ibrahim janë që të përkrahet Asociacioni duke involvuar aftësitë dhe përvojat e kryeshefave ekzekutiv dhe stafit tjetër komunal: "të asistojnë në përgatitjen e raporteve të Asociacionit, ta ngrisin kooperimin multikomunal dhe të forcojnë komunikimin ndërmjet komunave e gjithashtu të forcojnë komunikimin ndërmjet komunave dhe të AKK-së".

Duke vlerësuar se ekzistimi i një trupi këshillëdhënës i përbërë nga kryetarët e ekzekutiv të komunave të Kosovës, është tejet i rëndësishëm dhe i nevojshëm, Asociacioni i Komunave të Kosovës formoi Bordin Këshillëdhënës të përbërë nga 7 kryeshefa ekzekutiv të komunave të ndryshme të Kosovës.

Anëtarë të Bordit Këshillëdhënës të Kryeshefave Ekzekutiv të Komunave të Kosovës janë zgjedhur Sami Hamiti – Komuna e Prishtinës, Enver Muja – Komuna e Gjilanit, Astrit Haraçia – Komuna e Gjakovës, Naim Ismajli – Komuna e Shtimës, Mustafë Pllana – Komuna e Mitrovicës, Ragip Gajraku – Komuna e Prizrenit dhe një vend është i rezervuar për komunitetin serb.

Në fund të takimit kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Lutfi Haziri tha se ne në AKK e kemi marrë këtë vendim vitin e kaluar për të harmonizuar më mirë qëndrimet dhe politikat operationale të pushtetit lokal, andaj sa është i rëndësishëm formimi i Kuvendit të AKK aq edhe formimi i sotëm i Bordit këshillëdhënës të Kryeshefave Ekzekutiv.

Përfaqësuesit e AKK-së priten një delegacion të Këshillit të Evropës



Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe i komunës së Gjilanit z.Lutfi Haziri dhe kryetari i Prishtinës z.Ismet Beqiri e anëtar i Bordit të AKK-së janë takuar me një delegacion të Këshillit të Evropës i kryesuar nga z.Philip Blair - drejtor gjeneral për bashkëpunim Lokal e Regjional në Këshillin e Evropës. Në këtë takim u bisedua për reformën në pushtetin Lokal në Kosovë ku përfaqësuesit e AKK-së paraqiten pikë-pamjet e pushtetit lokal të Kosovës. Njëkohësisht, kryetari Haziri dhe kryetari Beqiri paraqiten edhe të arriturat dhe sfidat e pushtetit Lokal të Kosovës. Përfaqësuesit e Këshillit të Evropës premtojnë angazhim edhe më të madh në përkrahje të pushtetit lokal në vendin tonë.

Komisioneri i BE-së për Politikë të Jashtme Kris Paten takoi përfaqësuesit e Asociacionit të Komunave të Kosovës

Gjatë vizitës së tij në Kosovë, Komisioneri i BE-së për Politikë të Jashtme Kris Paten ka takuar edhe delegacionin e AKK-së të prirë nga kryetari z.Lutfi Haziri. Në këtë takim, nga përfaqësuesit e komunave kanë marrë pjesë z.Ismet Beqiri kryetar i komunës së Prishtinës, z.Ramadan Gashi kryetar i komunës së Skënderajit, Petar Vasic kryetar i komunës së Novobërdos dhe z.Sazan Ibrahim drejtor ekzekutiv i përcaktuar i AKK-së. Delegacioni i kryetarëve të komunave e ka njoftuar Paten me aktivitetin e komunave të Kosovës e sidomos në sanimin dhe rindërtimin e objekteve të dëmtuara gjatë trazirave të marsit. Z.Kris Paten ka kërkuar nga kryetarët e komunave që edhe më shumë të angazhohen në qetësimin e situatës dhe të punojnë në sanimin pasojave si dhe në rindërtimin e dëmeve me të cilat janë pajtuar edhe kryetarët e komunave.

FOTOLAJM



Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Lutfi Haziri me rastin e vdekjes së ish-presidentit Ronald Regan, vizitoi Zyrën amerikane në Prishtinë. Kryetari Haziri pasi i shprehu ngushëllime stafit të kësaj zyre për vdekjen e Presidentit Regan, u nënshkrua në librin e zisë.

Delegacioni i AKK-së mori pjesë në Konferencën e “Qyteteve dhe Qeverive Lokale të Bashkuara” në Francë



Delegacioni i AKK-së gjatë Konferencës



Kryetarët Gani Krasniqi, Lutfi Haziri, Ismet Beqiri dhe Fehmi Mujota gjatë Konferencës



Takimi i kryetarit të AKK-së z.Lutfi Haziri me kryetarin e Parisit z.Bertrand Delanoë

Delegacioni i Asociacionit të Komunave të Kosovës mori pjesë në Konferencën themeluese të organizatës së re botërore të “Qyteteve dhe Qeverive Lokale të Bashkuara” e cila rezultoi me bashkimin e tri organizatave kryesore të qeverisjes lokale në botë, IULA, FMCU dhe Metropolis.

Delegacioni i AKK-së, i udhëhequr nga kryetari z.Lutfi Haziri përbëhej nga z. Ismet Beqiri kryetar i Prishtinës, z.Eqrem Kryeziu kryetar i Prizrenit, z.Fehmi Mujota kryetar i Shtimës dhe

z. Gani Krasniqi kryetar i komunës së Malishevës. Konferencën e “Qyteteve dhe Qeverive Lokale të Bashkuara” e ka hapur presidenti i Francës z.Zhak Shirak ndërsa ajo është mbajtur nën patronatin e kryetarit të Parisit z. Bertrand Delanoë. Delegacioni kosovarë ka marrë pjesë në të gjitha sesionet plenare në kuadër të konferencës, ku poashtu delegacionet janë angazhuar edhe në grupe e veçanta punuese për tema të caktuara. Poashtu kryetari i Asociacionit të Komunave të

Kosovës z.Lutfi Haziri është takuar me kryetarin e Parisit z. Bertrand Delanoë, i cili ka marrë edhe një letër nga kryetari i Prishtinës z.Beqiri dhe ka premtuar se do ta vizitoj Prishtinën. Delegacioni i AKK-së dhe kryetarët e komunave të Kosovës kanë pasur takime edhe me kryetarin e Stambollit, atë të Buenos Airesit, përfaqësuesit e LGIB-së, përfaqësuesit e Këshillit të Evropës e shumë takime tjera me përfaqësues të pushtetit lokal nga mbarë bota.

Asociacioni i Komunave të Kosovës mori pjesë në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Regjionale të Këshillit të Evropës

Delegacioni i Asociacionit të Komunave të Kosovës nga 25 deri më 27 maj mori pjesë në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Regjionale të Këshillit të Evropës i cili u mbajt në Strasburg. Gjatë Sesioni Plenar në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Regjionale të Këshillit të Evropës, delegacioni i AKK-së ka lexuar edhe një deklaratë në të cilën thuhet :

“Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka nderin të jetë në Strazburg si vëzhgues në punimet e Kongresit.Asociacioni i Komunave të Kosovës e falenderon përkrahjen dhe kooperimin e juaj me ne, e sidomos duke i marrë në konsideratë vështirësitë në territorin tonë. Të 30 Komunat e Kosovës janë duke e rritur eksperiencën dhe duke u fokusuar në bregat e veta. Sidoqoftë, në jemi duke u ballafaquar me ricalizim të fuqishëm. AKK-ja është duke e promovuar Kartën Evropiane mbi vetëqeverisje Lokale dhe lufton të mirëmbajë dhe zhvillojë strukturat tona të decentralizuara. Ne do të koeporojmë me tërë energjinë tonë duke u përgjegjur në të gjitha pyetjeve të parashtruara nga Kongresi në mënyrë që t’ju informojmë Ju me pozitën e komunave tona. AKK-ja në mënyrë të hapur e ka dënuar dhunën e marsit. Kryetarët e Komunave personalisht dhe së bashku kanë apeluar për rend dhe qetësi. AKK – ja ka ndihmuar në koordinimin e vlerësimeve të dëmeve të marsit në Kosovë. Gjithashtu, ne jemi duke kërkuar një dialog të ri në nivelin Komunal dhe në atë të fshatrave. Ne kemi nevojë për një pjesëmarrje të lirë dhe aktive për të gjithë në strukturat ekzistuese dhe akcion të Qeverisë në jetën civile. Kongresi ka propozuar se Rekomandimet mbi Reforma në vetëqeverisjen lokale duhet të konsiderohen si një rrugë e cila të çon përpara. Z. Sofianski (Përfaqësues i Bullgarisë në Kongres) ka raportuar që AKK-ja është kundër rekomandimeve të Misionit të Decentralizimit në Kosovë. Ne dëshirojmë të sqarojmë se ne i kundërshtojmë ndërrimet territoriale të cilat janë komplekse, gjithashtu, shumë të shtrejtja si të tilla dhe që është propozuar pa konsultime paraprake. Sidoqoftë, ne nuk e kundërshtojmë një decentralizim që përmirëson situatën: ne kërkojmë shërbime publike dhe administratë më të mirë.”

Delegacioni i AKK-së nënshkroi statutin e Rrjetit të Asociacionit të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS) në Strasburg

Poashtu delegacioni i Asociacionit të Komunave të Kosovës me 27 maj mori pjesë edhe në ceremonialin e nënshkrimit të statutit të Rrjetit të Asociacionit të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS) në Strasburg. Me këtë rast nënkryetari i AKK-së z.Ramadan Gashi ka nënshkruar statutin e NALAS-it ku Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) është anëtar i përhershëm me të drejta të plota.



Delegacioni i AKK-së mori pjesë në Konferencën e “Qytetet dhe qytezat e qëndrueshme”

Për herë të parë në këtë konferencë ndërkombëtare mori pjesë edhe delegacioni nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, i përbërë nga kryetari i komunës së Podujevës z.Agim Veliu, kryetari i komunës së Skënderajt z.Ramadan Gashi dhe kryetari i komunës së Kamenicës Z. Shaip Surdulli kryetari i komunës së Lipjanit z.Xhevat Olluri.

Për herë të parë në Konferencën e IV-të Evropiane mbi “Qytetet dhe qytezat e qëndrueshme” e cila u mbajt në qytetin e Aalborgut në Danimarkë mori pjesë edhe delegacioni nga Asociacioni i Komunave të Kosovës. Kjo konferencë shënon edhe dhjetëvjetorin e punës së saj që nga konferenca e parë e organizuar po në Aalborg me ç’rast nga 80 autoritete lokale është nënshkruar dokumenti i

njohur si “Karta e Aalborgut”. Ky numër, pas dhjetë vjetësh, është rritur në mbi 2000 duke përfshirë këtu edhe katër komunat pjesëmarrëse nga Kosova. Konferenca i zhvilloi punimet në seanca plenare dhe në sesione ndërsa ditë e tretë dhe të fundit u nënshkrua dokumenti final “Zotimet e Aalborgut”. Ky dokument që përmban dhjetë zotimet kryesore u nënshkrua nga mbi 110 Autoritetet lokale duke përfshirë

edhe katër kryetarët e komunave të Kosovës. Konferenca “Aalborg+10” u përhëndet përmes videolidhjes edhe nga Komisionerja Evropiane për Mjedisin, Znj. Margot Wallström. Konferenca ishte një rast i mirë për vendosjen e kontakteve mes përfaqësuesve të shteteve të ndryshme, shkëmbimin e ideve dhe përvojave nga vende të ndryshme mbi çështje me rëndësi për autoritetet lokale.

KËSHILLI I KRYETARËVE TË KOMUNAVE TË KOSOVËS U TAKUAN ME MINISTRIN ALI SADRIU LIDHUR ME NDARJEN E SUFICITIT BUXHETOR

Projektet e Komunave çdoherë kanë qenë prioritet në Qeverinë e Kosovës, por...

Duhet të rishikohet vendimi për suficitin sepse komunat janë të vetmet institucione që merren direkt me zgjedhjen e problemeve të përditshme të qytetarëve të Kosovës - thanë kryetarët e komunave të Kosovës gjatë takimit me ministrin Ali Sadriu

Kryetarët e komunave të Kosovës janë takuar me ministrin e Ekonomisë dhe Financave z.Ali Sadriu lidhur me ndarjen e suficitit buxhetor. Siç dihet rekomandimet e Qeverisë së Kosovës në lidhje me këtë ndarje u kanë dhënë prioritet Projekteve Kapitale të Komunave në vlerë prej 21 milion euro. Ministri z.Ali Sadriu theksoi se qëndrimi i Qeverisë së Kosovës nuk është përkrahur gjatë takimit me Këshillin Ekonomik Fiskal. Ai shtoi se Komisioni për buxhet është takuar tri herë gjatë javëve të shkuara dhe në takimin e fundit të mbajtur më 25 maj 2004 ka diskutuar shumë prej € 37.2 milionë, të mbetura nga suficiti 2003 dhe ka shqyrtuar listën e kërkesave në shumë prej € 235 milionë, të paraqitura nga organizatat buxhetore për shfytëzimin e atij suficiti. Pastaj ka përcaktuar prioritetet më të rëndësishme mbarë-kosovare nga lista e kërkesave prej € 235 milion, që arrin shumë totale rreth € 100 milionë si dhe ka identifikuar burimet potenciale të shumës prej € 63 milionë në fondet shtesë që nevojiten (në mes suficitit në dispozicion dhe shumës totale të rekomanduara), dhe ka filluar punën teknike më zyrën e këshilltarit ligjor, për të ndërmarrë hapat e nevojshëm të veprimit në sigurimin e fondeve.

Komisioni për buxhet pas votimit të hapur me 4 vota pro, 2 kundër dhe një apstenim votoi që nga suficiti dhe shkurtimet e zotimeve të bartura nga viti i kaluar të financohet - grupi i parë € 21.0 milionë për investime në projektet kapitale komunale, € 10.0 milion për pensionet, € 7.0 milion për KEK-un, € 11.0 milion për fondin e rindërtimit të Kosovës (6.7 nga shkurtimet buxhetore plus € 4.3 milion nga BB), € 5.0 milion për të kompenzuar humbjet si rezultat i reduktimit të tarifave, € 8.5 milion për rrugë, € 3.0 milion për shkolla dhe € 1.0 milion Treni i lëvizjes së lirë. Në mbledhjen e rregullt të Qeverisë të mbajtur më 26.05.2004 u përkrahen shumica e propozimeve të komisionit për buxhet me një ndryshim të vogël që në grupin e parë të zbriten te rrugët për € 2.5 milionë dhe të financohet në grupin e parë TMK për € 2.5 milionë. Kështu tabelat e korigjuara do të ishin € 21.0 milionë për investimet në projektet kapitale komunale, € 10.0 milion për pensionet, € 7.0 milion për KEK-un, € 11.0 milion për fondin e rindërtimit të Kosovës (6.7 nga shkurtimet buxhetore + € 4.3 milion nga BB), € 5.0 milion për të kompenzuar humbjet si rezultat i reduktimit të tarifave, € 6.0 milion për rrugë, € 3.0 milion për arsim, € 1.0 milion Treni i lëvizjes së lirë, € 2.5 milion TMK-së. Ministri i Ekonomisë dhe Financave z.Sadriu shtoi se çdo herë komu-

nat e Kosovës dalin prioritare për Qeverinë e Kosovës në shpenzimin e suficitit buxhetor. Me këtë neve na është mbyllur dera për me ndikuar drejtpërdrejtë në jetën më të mirë të qytetarëve përmes rregullimit të infrastrukturës nëpër komunat e Kosovës.

Kryetari i Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Lufti Haziri tha se "institucionet qendrore të Kosovës duhet ta kenë të qartë se komunat kanë përgatitur ambientin për realizimin e projekteve kapitale të komunave andaj kryetarët e komunave kërkojnë rishikimin e ndarjes së suficitit. Bordi i Asociacionit të Komunave të Kosovës do të kërkojë nga zv.administratori Brayshow dhe kryeministri Rexhepi që të respektohen rekomandimet e Qeverisë së Kosovës për ndarjen e suficitit ku prioritet marrin komunat e Kosovës".

Kryetari i komunës së Ferizajit z.Adem Salihaj tha se "mosndarja e suficitit për projektet kapitale të komunave është dëshpëruese. Nevojave të mëdha të komunave nuk i është dhënë prioritet derisa ata janë kujdesur për prioritetet e KEK-ut. Rikthimi në ndarje të suficitit është mjaft i vështirë se këtë e ka treguar praktika e deritashme.

Mirëpo ata duhet të rishikojnë vendimet sepse komunat janë të vetmet institucione që merren direkt me zgjedhjen e problemeve të përditshme të qytetarëve të Kosovës".

Kryetari i Tharnadës z. Sali Asllanaj tha se "komunat duhet të dalin me qëndrime të përbashkëta dhe të jenë të vendosura për të përfituar mjete për nevoja të qytetarëve". Kryetari Ali Lajçi tha se "të drejtat e komunave ne duhet t'i kërkojmë edhe me rrugë ligjore dhe duhet të dihet kush po i shkel rregullat në Kosovë dhe ne duhet që të bëjmë ankesë të përbashkët". Kryetari Aqif Shehu pyeti të pranishmit se çfarë t'u themi ne tani qytetarëve meqë kemi bërë shumicën e përgatitjeve për realizimin e projekteve kapitale? Ndërsa kryetari i Novobërdos z.Predrag Vasiç tha se ne si komunë nuk kemi asgjë kundër KEK-ut apo PTK-së por jemi kundër asaj që mjetet e suficitit buxhetor i ndahen kompanive që mund të vetëfinancohen".

Këshilli i Kryetarëve të Komunave të Kosovës në fund të këtij takimi mori vendim që t'i drejtohet zv.kryeadmistratorit të Kosovës Brayshow për të kërkuar rishikimin e ndarjes së suficitit buxhetor.

LETRA E ASOCIACIONIT TË KOMUNAVE TË KOSOVËS DËRGUAR ZV.KRYEADMINISTRATORIT TË KOSOVËS Z.CHARLS BRAYSHOW LIDHUR ME NDARJEN E SUFICITIT

Mosndarja e mjeteve të suficitit për projektet kapitale të komunave do të ketë pengesa në zhvillimin e nevojave të përditshme të qytetarëve

"Me rastin e përcaktimit për ndarje të suficitit buxhetor, ku projektet kapitale të komunave të Kosovës në vlerë prej 21 milion euro janë injoruar tërësisht, përfaqësuesit e Kuvendeve Komunale të Kosovës kërkojnë rishikimin e këtij vendimi nga ana e Këshillit Ekonomik Fiskal. Asociacioni i Komunave të Kosovës që është edhe përfaqësues i komunave të Kosovës, ka organizuar një takim me Ministrinë për Ekonomi dhe Financa z.Ali Sadriu dhe kryetarët e Komunave të Kosovës në lidhje me këtë çështje.

Pasi ministri z.Ali Sadriu elaboroi tërë rrjedhën e përcaktimit të ndarjes së suficitit buxhetor e veçanërisht përcaktimin për prioritetet të Qeverisë së Kosovës për ndarjen e 21 milion për projektet kapitale të komunave, në këtë takim u tha se të hyrat vetanake të komunave nuk janë në nivel sa për të përmbushur nevojat e banorëve. Prandaj si pasojë e mosndarjes së 21 milion euro të kërkuara nga suficiti do të ketë pengesa në zhvillimin e nevojave të përditshme të qytetarëve. Komunat mendojnë se janë të nëpërkëmbur me rastin e suficitit dhe kërkojnë nga UNMIK-u që të mos nënshkruaj vendimin e marrë ditë më parë në KEF. Duke marrë parasysh rëndësinë e zhvillimit të komunave duhet të përkrahet realizimin i projekteve që kapin shumë prej 21 milion euro. Komunat kërkojnë trajtim të barabartë me ndërmarrjet publike dhe shpenzuese të buxhetit të Kosovës dhe kjo është hera e dytë që komunave po u mbyllën dyert ndërkohë që ne jemi institucionet që jemi më së afërmi me qytetarët. Në mënyrë unanime kryetarët e komunave të Kosovës kanë kërkuar që urgjentisht të rishqyrtohet ndarja e suficitit buxhetor".

Lufti Haziri, Kryetar i Asociacionit të Komunave të Kosovës

Deklarata parimore mbi Financa – Buxhetin e Komunave

Ky dokument ofron një shqyrtim të sistemit të financave publike komunale, veçanërisht nivelin e autonomisë financiare të komunave dhe rolin e tyre në marrëdhënjet me Qeverinë qendrore lidhur me çështjet buxhetore dhe thekson se:

Financat lokale në Kosovë vuajnë nga mungesa e përgjithshme e burimeve publike dhe të gjitha komunat janë shumë të varura financiarisht nga buxheti shtetëror

Një rishikim i marrëdhënjeve të qeverisë qendrore dhe lokale, lidhur me të gjitha çështjet financiare duhet të bëhet dhe sistemi i financimit të detyrave dhe obligimeve komunale duhet të hartohet në bashkëpunim të ngushtë me AKK-në në përputhje me Kartën Evropiane të vetëqeverisjes lokale.

Komunat duhet të kenë të drejtën për të përgatitur buxhetin duke u bazuar në burimet të

cilat mund të planifikohen dhe të ndahen siç duan ato, ndërkohë që përmbushin përgjegjësitë e tyre ligjore.

Të gjitha komunat marrin grante nga buxheti shtetëror, pa një politikë të qartë për alokimin e përshtatshme të burimeve financiare. Grante financiare merren nga të gjitha komunat dhe jo vetëm nga ato që ndodhen në rajonet e largëta apo më pak të zhvilluara. Vetëm përmes një analizë të gjithanshme, ne do të jemi në gjendje të përcaktojmë nëse burimet financiare korendojnë me detyrat që do të kryhen nga komunat në përputhje me ligjin.

Burimet financiare, që janë të hyra për komunat, nuk janë sa duhet të llojlojshme, për sa i takon shtrirjes së tyre. Ligji nuk përfshin një sistem të elaboruar të marrjes së pëlqimit apo qoftë edhe të mendimit në rastet kur autoriteti qendror (qeveria) merr

vendime që kanë të bëjnë me fondet e dhuruara për implementimin e detyrave brenda kompetencës së komunave.

Procedura për definimin e nivelit të financimit nga buxheti shtetëror është joadekuat meqë ajo nuk parashihet mundësinë që komunitetet lokale të bëjnë vërejtje ndaj llogaritjes së nivelit të granteve për një vit të caktuar.

Duhet të përgatitet urgjentisht një ligj mbi sistemin e financimit të komunave (që tani për tani nuk ekziston fare), me anë të të cilit duhet të merren në considerate, si një pikë fillestare, dispozitat e Kartës Evropiane të vetëqeverisjes lokale.

Shpenzimet apo detyrimet shtesë, të cilat shfaqen vetëm në komuna të veçanta, duhet të përcaktohen në mënyrë të përshtatshme nga ligji, me qëllim që të sigurohen financime shtesë (grante).

Deklarata Parimore mbi Licencimin

Situata aktuale në fushën e licencimit është e paqartë. Kjo vështirësohet edhe më tepër nga mungesa e bashkëpunimit mes palëve të ndryshme të përfshira si të nivelit qendror ashtu edhe të atij lokal. Në fakt, të gjitha fushat e regjistrimit të bizneseve janë centralizuar. Një shembull konkret është regjistrimi i bizneseve. Komunat nuk kanë më mundësi që t'i vëzhgojnë nga afër bizneset brenda territorit të tyre sepse qeveria qendrore e ricentralizoi këtë kompetencë në vitin 2002. Kjo ka patur një numër pasojash negative të cilat do të argumentohen më poshtë. Ky dokument ofron një shqyrtim të sektorit të licencimit dhe thekson se:

- AKK-ja riafirmoi rëndësinë e rregullimit të sektorit të licencimit,

- AKK-ja kërkon konsultime me IPVQ-të lidhur me politikën dhe

legjislacionin e propozuar që do të kenë ndikim në nivelin komunal,

- AKK-ja kërkon direktiva të qarta në çdo ligj të ri lidhur me përgjegjësitë e pushtetit qendror dhe qeverisë komunale,

- Komunave duhet t'u jepen kompetenca meqë ato e njohin realitetin në terren dhe mund të bëjnë zbatimin e ligjit,

- Regjistrimi i bizneseve duhet të kalojë përmes Komunave,

- Shkëmbimi i informacionit duhet të jetë më efektiv mes komunave dhe mes komunave dhe qeverisë qendrore,

- Nevojitet hartimi i infrastrukturës ligjore dhe rregulloreve komunale,

- Ngritja e kapacitetit të stafit profesional,

- Definimi i qartë i regjistrimit dhe licencimit.

AKK-ja DHE CARE International VAZHDUAN DEBATIN ME LIDER TË LOKALITETEVE NË RAJONIN E GJILANIT

Shumica në Kosovë ka qëndrimin pozitiv në raport me komunitetet

Në pjesën e debatit, duke i paraqitur pikëpamjet e tyre, përfaqësuesit e lokaliteteve të ndryshme nga rajoni i Gjilanit, kanë theksuar se shqiptarët, përgjithësisht kanë dëshmuar gatishmërinë e tyre për të ndërtuar relacione të mira me pakicat në Kosovë, por jo gjithëherë ka pasur gatishmëri te të tjerët.

Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me CARE International ka vazhduar serinë e debateve me lider të fshatrave të lokaliteteve të ndryshme në rajonin e Gjilanit.

Duke marrë pjesë në këtë debat, zëvendëskryetari i Kuvendit Komunal të Gjilanit theksoi se "komuna e Gjilanit ka investuar shumë në integrimin e komuniteteve dhe deri më 17 mars shquhej për përparimet e bëra në këtë drejtim, kurse ajo është angazhuar për të siguruar një integrim funksional të komuniteteve në shoqëri dhe institucione lokale" Z.Hyseni duke folur në temën "Marrëdhëniet ndëretnike - ballafaqimi me tensione dhe kapërcimi i tyre" ka theksuar se pas luftës, në Kosovë është krijuar një realitet i ri politik dhe se ishte e nevojshme të ndërtoheshin raporte të reja dhe ndërmjet pop-

ullatës shumicë dhe komuniteteve.

Ai ka shtuar se "vendosmëria e institucioneve tona, që nga niveli qendror deri tek ai komunal për t'u marrë energjikisht me sanimin e gjendjes dhe pasojave të trazirave të marsit, dëshmon qëndrimin pozitiv të shumicës në raport me komunitetet, të cilat jetojnë në Kosovë e Gjilan ka pasur sukses të mirë në menaxhimin e krizës dhe përballimin e pasojave të saj". Zëvendëskryetari i komunës së Gjilanit ka vazhduar se "komuna synon të bëjë më të qëndrueshëm integrimin e komuniteteve duke iu mundësuar atyre që t'i zhvillojnë të gjitha kapacitetet e veta reale në shoqërinë kosovare dhe në institucionet lokale e qendrore".

Në pjesën e debatit, pikëpamjet e tyre i kanë paraqitur edhe përfaqësuesit e lokaliteteve të ndryshme nga rajoni, të

cilët kanë theksuar se shqiptarët, përgjithësisht kanë dëshmuar gatishmërinë e tyre për të ndërtuar relacione të mira me pakicat në Kosovë, por jo gjithëherë ka pasur gatishmëri te të tjerët, përderisa kishte edhe mendime se serbët po përkthelen më shumë sesa që duhet nga ndërkombëtarët, ndërsa Serbia po vazhdon t'i trimëroj ata se mund të kthehet përsëri në Kosovë. Debatuesit thanë se duke shpresuar në premtimet e rrëzshme të Beogradit, serbët sikur po hamenden edhe më tutje për ta pranuar dorën e zgjatur për bashkëpunim e nëse dikush në Kosovë e ka ndjenjën e frikës pse është pakicë, është obligim i shumicës që t'i ndihmojë ata ta përballojnë këtë ndjenjë dhe të ndjehen të lirë, të sigurtë dhe të barabartë - u tha ndër të tjera në këtë debat.

Për të relaksuar marrëdhëniet ndëretnike duhet të flasim me gjuhën ekonomike

Në debatin për promovimin e dialogut lokal të cilin e ka hapur z.Sazan Ibrahim – drejtor ekzekutiv i përcaktuar i AKK-së kanë debatuar së bashku edhe z.Illir Dugolli këshilltar i kryeministrit, z.Xhevat Olluri kryetari i komunës së Lipjanit dhe përfaqësuesit lokaliteteve Lagjja e Re- Lipjan, Obiliq i vjetër- Obiliq, Godancë- Shtime, Livadicë-Podujevë, Lagjja Dodona.

Asociacioni i Komunave të Kosovës në bashkëpunim me udhëheqës të fshatrave Lagjja e Re- Lipjan, Obiliq i vjetër- Obiliq, Godancë- Shtime, Livadicë- Podujevë ka organizuar debatin në temën "Stabilizimi përmes realizimit të të drejtave dhe tolerancës".

Në fjalën hyrëse të hapjes së debatit, z.Sazan Ibrahim drejtor ekzekutiv i përcaktuar në AKK tha se "ky takim është inicuar nga AKK-ja kurse ndihmesë të madhe në organizimin e kësaj tryeze ka dhënë edhe OJQ "Care". Qëllimi i këtij takimi është t'u ndihmojë komunitetet që ta zhvillojnë kapacitetin që në mënyrë të pavarur t'i menaxhojnë konfliktet, dhe për të mundësuar dialog dhe ndërveprim konstruktiv me qëllim të krijimit të një integriteti etnik të qëndrueshëm dhe të suksesshëm. Kosova ka vërtetuar se ka fuqi të përballet me këto sfida dhe të mbrojë interesat dhe integritetin e vet duke vazhduar dialogun politik. Ne nuk do të heqim dorë nga angazhimi ynë që duhet të bisedojmë për të gjitha çështjet e hapura dhe se të gjitha këto çështje duhet të zgjidhen brenda institucioneve kosovare. AKK-ja së bashku me Komunitet dhe Institucionet e Kosovës do të mundohet të eliminojë të gjitha arsytet për tensione ndëretnike, pa dëmtuar procesin e integritetit të të gjithë qytetarëve në shoqërinë e Kosovës. Qëllimi ynë është ndërtimi i një shteti demokratik. Duke marrë parasysh se fshati është njëri ndër vendet më të afërta të qytetarit, AKK-ja beson se disa probleme mund të zgjidhen duke filluar po nga ky nivel. Kjo është e domosdoshme dhe ne si AKK do të mundohemi që përmes mekanizmave insitucional të fillojmë të mendojmë për zgjidhjen e disa problemeve që e preokupojnë qytetarin e Kosovës" – tha ndër të tjera z.Ibrahimi.

Duke marrë pjesë në këtë debat z.Illir Dugolli, këshilltar i kryeministrit të Kosovës tha se "falenderojmë AKK-në dhe CARE për këtë takim e mbi të gjitha për punën që po bëjnë në plotësimin e standardeve. Sepse ne kemi obligim të përmbushim standardet sepse kriteret janë për me përmirësuar veten dhe nuk duhet të frikësohemi por të punojmë për realizimin e tyre sepse ato janë të mundshme. Komentet dhe sugjerimet si në këto takime janë shumë të nevojshme e të mira për Qeverinë e Kosovës

dhe të gjithë neve që jemi të implikuar në procesin e plotësimin të standardeve. Qeveria është idhtarë e këtyre takimeve e jo panove, reklamave e fjalëve boshe për standardet". Përfaqësuesja e UNCHR-së znj.Ariana Zherka tha se "standardet janë e vetmja rrugë për me dalë nga varfëria dhe me iu bashkangjitur familjeve evropiane. Çështja e kthimit është shumë komplekse dhe shumë sektorëshme. Problemet ekonomike na kthejnë te procesi i kthimit të Standardeve.Secili projekt i kthimit dhe ndërtimit të shtëpive bëhet i balancuar me sistemin 50 me 50 ku këtë pjesën e dytë e përfiton komuna për infrastrukturë në atë lagje. Vetëm varet si identifikohet nevojat atje. Për shqiptarët e zhvendosur procedurat tona vlejné njëjtë si për serbët e zhvendosur. Ne i përmbahemi parimit secili të kthehet në lagjen dhe shtëpinë e vetë. Në këtë kuadër duhet të punojmë që kthimi të jetë i qëndrueshëm dhe dua të shtoj në fund se toleranca në këtë debat është e madhe". Kryetari i komunës së Lipjanit z.Xhevati Olluri tha se "kemi pas arritur një përparim të mirë pas lufte dhe nuk ka pasur zhvendosje të mëdha të komuniteteve e ngjarjet e marsit lënduan marrëdhëniet në komunë. Ne po përpiqemi ti bindim ata për kthimin e besimit dhe kështu kemi bërë disa hapa si në vlerësimin e dëmeve".

Duke marrë pjesë në debat përfaqësuesi i lagjes Lagjja e Vjetër nga Lipjani Ibrahim Bilalli tha se "ne jemi të gatshëm të bashkëpunojmë për plotësimin e standardeve mirëpo ana tjetër nuk është e gatshme për takime e as për plotësimin e standardeve. Duhet të dihet kush është penguesi i realizimit të standardeve dhe ata që marrin nga 3-4 paga çfarë standarde mund të plotësojnë". Agim Pacolli - Lagjja Dodona tha se "në lagjen tonë ekziston një dia-

log dhe një komunikim mes komuniteteve. Mirëpo ne kemi vërejtje pse tentohet që gjatë procesit të kthimit vetëm një komuniteti ti ndërtohet shtëpitë për kthim. Kështu prishet balancimi dhe komunikimi mes komuniteteve dhe të të kthyerve".

Rexhep Bunjaku Lagja Dodona tha se "ne kemi pasur 7 vizita në komunitet pas trazirave pa asnjë ekces dhe ka filluar rindërtimin i shtëpive të atyre që u dëmtuan dhe gjendja po shkon normalisht. Poashtu në lagjen tonë do të ketë kthime të romëve në pronat e tyre dhe përkundër se një pjesë e tyre është e uzurpuar, të cilat do të lirohet sepse prona është e pakontestueshme vetëm se duhet të dëshmohe dokumentet e pronësisë".

Fadil Blaca - Subotiq nga komuna e Obiliqit tha se "kur ndërtohet shtëpia e një të kthyerit duhet që edhe shtëpia e fqinjët të të kthyerit të ndërtohet dhe të balansohet mundësia dhe ndihmesa edhe në punësim për të ecur ata ekonomikisht njëjtë". Adem Bajcinca nga Mazgiti i Obiliqit tha se "pa infrastrukturë të mos ndërtohet shtëpitë për të kthyerit".

Ibrahim Nuredini nga komuna e Shtimes pyeti se "si ti bindim familjet e personave të vrarë dhe të zhdukur për kthimin e serbëve. Ne të gjithë jemi për kthimin e atyre që më parë kanë jetuar në fshatin tonë dhe që duan të jetojnë në Kosovë. Si me bë dialogun me serbët kur ata nuk janë të interesuar, ku ti marim apo ti gjejmë ata". Në pjesën e 4 të Konferencës kreu i komunës së Lipjanit z.Xhevat Olluri tha se "në kuadër të standardeve është edhe integrimi i bashkësive tjera ku nevojitet një dialog ndëretnik edhe në nivelin e komuniteteve. Secili dialog që prek statusin është i vështirë prandaj këto debate kështu janë më të lehta për jetën e përditshme".

Rekomandimet e Debatit:

- Proces i kthimit të jetë transparent.
- Të njoftohen edhe qytetarët e thjeshtë për standadet dhe implementimin e standardeve tyre praktik në kuadër të kthimit të të zhvendosurve.
- Komunikimi ndërkomunal të jetë më i efektshëm.
- Shkëmbimi i përvojave në raste të kthimeve në vende të caktuara.
- Kushtet e ofruara nga ndërkombëtarët të ndikojnë në balancimin e jetës dhe relacioneve ndëretnike.

DEBAT NË OSBE I KRYETARËVE TË KOMUNAVE NË TEMËN:

"Çfarë mund të bëjnë udhëheqësit komunalë të Kosovës për të krijuar ambient stabil dhe parandaluar dhunën?"

Me iniciativën e AKK-së dhe nën organizim të përbashkët me Këshillin e Evropës, UNDP-së dhe OSBE-së, kryetarët e komunave të Kosovës kanë debatuar në temën "Çfarë mund të bëjnë udhëheqësit komunalë të Kosovës për të krijuar ambient stabil dhe parandaluar dhunën"? Takimin e hapi z. Hartmut Purner udhëheqës i ekipit përkrahës për Vetëqeverisje Lokale dhe nëndrejtor për Demokratizim në OSBE. Shefi i UNDP-së z. Robert Piper në hapje të këtij takimi tha se më shumë dëshiron të dëgjoj debatet mes kryetarëve të komunave në lidhje me këtë temë. Udhëheqësi i këtij takimi z.Owen Masters nga Këshilli i Evropës shtoi se "rëndësia e Vetëqeverisjes Lokale është e madhe sepse ajo luan rol kyq në jetën e qytetarëve të thjeshtë. Ne po përpiqemi të shmangim pasojat e trazirave të marsit dhe të punojmë që ato të mos ndodhin". Z.Ismet Hashani kryetar i komunës së Obiliqit tha se "raportet ndëretnike në Obiliq nuk

janë të destabilizuara. Komunitetet tjera marrin pjesë në Komisionin për Politikë dhe Financa, respektojnë Rregulloren 2000/45 dhe me propozimin e përfaqësuesve serbë, Kuvendi Komunal i Obiliqit ka marrë vendim për ngritjen e Qendrës Rinore në Pletetin. Ne mendojmë që integrimi i serbëve në jetën institucionale është në interesin e të gjithëve në Kosovë". Z.Petar Vasiq – kryetar i komunës së Novobërdës tha se "komuna ime është e pazhvilluar dhe në zgjedhjet lokale kanë marrë pjesë shumë parti. Ne ia kemi dalë mbanë dhe vendimet në Kuvendin Komunal i sjellim njëzëri, prandaj edhe nuk kemi probleme me vendimet. Që Kosova të jetë multietnike duhet që të gjithë të angazhohemi në këtë drejtim. Kurse me takimet sikur këto ne bëjmë hapa përpara". Z.Skënder Zogaj – kryetar i komunës së Fushë-Kosovës tha se "komuna e Fushë-Kosovës është ndër komunat më stabile kurse multietniciteti këtu funksionon që nga

viti 1999 dhe kështu nuk kemi pasur asnjë konflikt, as më të voglin edhe pse atje jetojnë më shumë se tri komunitete. Ne në komunë kemi një administratë të përzier dhe kjo funksionon shumë mirë. Krijimi i institucioneve duhet patjetër të bëhet përmes mekanizmave zgjedhës dhe ky përfaqësim do të jetë sa më afër qytetarëve. Institucionet parralele në komunën tonë kanë amortizuar mjaft punën e Kuvendit Komunal dhe unë me të drejtë i kam quajatur ato struktura ilegale. Është e vërtet se trazirat e marsit na kanë larguar pakëz, mirëpo nuk është këputur lidhja institucionale dhe kështu ne së bashku po punojmë në sanimin dhe rindërtimin e pasojave të trazirave të marsit". Z.Mursel Ibrahim - nënkryetari i komunës së Mitrovicës pyeti se "si mund të kemi di administrata dhe të kemi standarde të dyfishta në Mitrovicë. Në një pjesë të qytetit respektohet ligjet dhe rregulloret kurse në tjetrën jo".

Secili Ligj do të jetë më i mirë se Rregulloret e UNMIK-ut

Në debatin publik për Reformimin e Pushtetit Lokal dhe me temën " Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë " i cili u organizua nga Asociacioni i Komunave të Kosovës u tha se deri më tani pushteti lokal në Kosovë ka qenë i organizuar dhe ka funksionuar në bazë të Rregullorës së UNMIK-ut 2000/45.

Në sesioni i hapjes së debatit z.Sazan Ibrahim i drejtor ekzekutiv i përcaktuar në AKK pasi u dëshiroi mirëseradhi të pranishmëve njoftoi për hartimin e draft Ligjit për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë nga ana e MSHP si dhe theksoi se ky draft Ligj është në debat publik nëpër Kuvendet Komunale të Kosovës të cilët po japin vërejtjet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me këtë draft-Ligji. Ai shtoi se "debatet për Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë edhe nëpër Kuvendet Komunale por edhe në nivel qendror nga Asociacioni i Komunave të Kosovës është mjaft i nevojshëm sepse ekziston vullneti i të gjithëve që Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale në Kosovë ta bëjmë sa më të mirë e funksional sepse rregullimi legjislativ është i rëndësishëm meqë komunat përçdo ditë përballen me problemet dhe jetën e qytetarëve".

Hysni Bajrami - Drejtor i Departamentit për Administratë Lokale në MSHP duke folur për Ligjin për Vetëqeverisje Lokale në Kosovë tha se "ka një kohë të gjatë që jemi duke punuar për përpilimin e ligjit për administratën lokale pasi proceset e deritashme kanë treguar se Rregullorja 2000/45 është e tejkaluar. Statusi i komunave është i njëjtë për të gjitha komunat dhe për këtë kemi parë arsyen që të reformohet pushteti lokal. Me këtë ligj do të definohen raportet mes pushtetit lokal dhe atij qendror në Kosovë. Pushteti Lokal në Kosovë duhet të reformohet sepse Rregullorja 2000/45 tashmë është e tejkaluar. Ndarja territoriale është e trashëguar nga pushteti i vjetër dhe tashmë duhet të bëhet ndarja territoriale komunale sepse nuk mund të jenë komuna të barabara edhe Prishtina që ka 300-400 mijë banorë sikur një komunë tjetër që ka 3000 banorë. Ligji është disejnuar në këtë formë që fillon proceset e reformimit të pushtetit lokal në Kosovë e i cili process mund të zgjas 3-5 vite. Modelet më të përshtatshme të reformimit të pushtetit lokal janë marrë nga reformimet e pushtetit lokal në vende të ish-Jugosllavisë modeli sllloven dhe ai maqedon". Gani Sylja - kryetar i komunës së Drenasit tha se ne si komunë i kemi dërguar vërejtjet tona me shkrim. Ne pajtohemi që kryeqyteti të marrë një trajtim tjetër nga komunat me këtë ligj dhe e përshëndesim



lokale dhe ne mendojmë se pavarësisht çfarë do të jetë ky ligj, me siguri se do të jetë më i mirë se Rregullorja 2000/45 dhe rregulloret tjera të UNMIK-ut që kanë rregulluar fushën e veprimtari të qeverisjes lokale në Kosovë. Alan Packer - Udhëheqës i IFES Ltd. tha se gjithmonë do të ketë vështirësi në realizimin e disa kompetencave që parasheh ligji mirëpo unë them që të diskutohet ende dhe të gjendet zgjidhja adekuate për kompetencat e të gjitha komunave. Drafti parashikon se përgjegjësia për ujësjellës i mbetet komunës e nëse ky është rasti, duhet të precizohet transferimi i përgjegjësisë nga AKM-ja. Shqetësimi im më i madh shkon në përpilimin e sa më shumë detajeve dhe skjarimeve sa më të plota. Poashtu duhet të kemi kujdes që të bëhet shumë qartë identifikimi i përgjegjësisë dhe kompetencave me legjislacionin sekondar dhe në fund propozoj që ky debat të shkojë më tutje".

Hysni Bajrami - Drejtor i Departamentit të Administratës Lokale në MSHP tha se "ne do të specifikojmë çdo përgjegjësi të komunave edhe përmes urdhërave administrative dhe poashtu ne planifikojmë edhe 21 ligje tjera në këtë drejtim. Pra me ligj specifikohet çdo gjë dhe do të dihen qartë kompetencat e komunave. Nëse komuna jap mjete ka të drejtë edhe me marrë hua apo të ngjashme për zhvillimin e tij".

Muharrem Shabani - Kryetar i Komunës së Vushtrrisë tha se "çështja e reformimit të pushtetit lokal ka hyrë edhe në agjendat e Këshillit të Evropës, Këshillit të Sigurimit, Bashkimit Evropian dhe administratës së ShBA-ve. Ky draft ligj ka marrë edhe përmasa politike mirëpo ne duhet të bazohemi në parimet e Kartës për Vetëqeverisje të Këshillit të Evropës. Rregullorja 2000/45 ka qenë një këmbështetë e ngushtë për funksionimin e pushtetit lokal në Kosovë dhe tani komunat e Kosovës nuk e kanë mundësinë e ofritit të kushteve për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik". Thomas Potocki përfaqësues i USAID-it tha se "edhe ne jemi të interesuar për këtë projekt sepse USAID-i ka një pilot program të vetin të cilin synon ta realizoj për një periudhë afatgjatë në funksionalizimin e pushtetit të qeverisjes lokale. Për hartimin e një kornize për qeverisjen lokale në të cilën është involvuar edhe USAID-i duhet të ketë një bashkëpunim shumë të ngushtë në mes të grupit punues për hartimin e Kornizës për qeverisje Lokale dhe të vetë MSHP duke përfshirë këtu edhe përfaqësuesit e pushtetit lokal në Kosovë".

Virginie Wyait përfaqësuese e OSBE-së tha se "zyra jonë ka qenë mjaft e involvuar në debatet e Kuvendëve Komunale gjatë shqyrtimit të këtij Draft Ligji dhe nëse kërkohet nga ne atëherë jemi të gatshëm që edhe zyrtarisht të sjellim mendimin tonë të këtyre debateve".

Michael Palenbach nga USAID / RTI në fjalën e vetë uroj Asociacionin e Komunave të Kosovës, komunat dhe MSHP për siç u shpreh ai këtë punë të madhe që po bëni dhe keni qasje shumë të sinqertë, pra edhe atë të përgjegjësive meqë ju jeni të vetëdijshëm se ballafaqohen me problemet të përditshme.

Alan Packer: Drafti parashikon se përgjegjësia për ujësjellës i mbetet komunës e nëse ky është rasti, duhet të precizohet transferimi i përgjegjësisë nga AKM-ja. Shqetësimi im më i madh shkon në përpilimin e sa më shumë detajeve dhe skjarimeve sa më të plota.



këtë Ligj i cili do të rregulloj shumë çështje në pushtetin lokal dhe raportet me atë qendror. Naim Ismajli - Kryeshf Ekzekutiv i Komunës së Shtimës tha se komunat duhet të kenë të qartë fushën e kompetencave por gjithsesi edhe të përgjegjësisë. Ky do të jetë Ligj bazik konsultativ për ligjet tjera që kanë të bëjnë me komunat. Me këtë dhe ligjet tjera përcjellëse nuk do të kemi konflikte kompetencash me institucionet qendrore. Pas një debati nëpër Kuvendet Komunale dhe të ekspertëve mendoj se do të jetë një Ligj që do të mbulojë zbrastësinë që ishte deri më tani në këtë fushë dhe mendojmë se do të ndërtohet një administratë e bazuar mbi këtë ligj". Mustafë Pllana - Kryeshf Ekzekutiv i Komunës së Mitrovicës tha se më mirë një ligj i keq sesa të mos kemi fare Ligj për qeverisjen

ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

BULETINI

Viti I, Nr. 4 - Maj & Qershor 2004

Adresa: Rr.Isa Kastrati, Nr.113
Tel&Fax: 038 / 245 - 734
komunat_akk@hotmail.com



Statusin e Vëzhguesit



Asociacioni i Komunave të Kosovës
Association of Kosovo Municipalities
Asociacija Kosovskih Opština



Anëtar i përhershëm